# Infrastrukture

| Data | Premtimi | Linku | Screenshot |
|---|---|---|---|
| 12/5/2023 | Aeroporti, Skipista, Stadiumi dhe Poli i Jugut janë projektet tona të mëdha që do të nxisin turizmin e sportit, natyrës dhe aventurës. | |  |
| 11/5/2023 | Një Resort Dimëror fantastik së bashku me Skipistën do i shtohen Korçës si një vlerë e jashtëzakonshme për turizmin dhe sportet dimërore. Ndërtimi i tyre në një nga zonat më të bukura malore të Korçës do të jetë një potencial për turizmin rajonal dimëror dhe do të ndikojë në zhvillimin e zonës dhe rritjen e të ardhurave nga ky sektor. | |  |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 10/5/2023 | Kemi projektuar në mandatin e ardhshëm edhe krijimin e një lagjeje të re të teknologjisë, si një mundësi e shkëlqyer banimi për të rinjtë e angazhuar në fushën e teknologjive të informacionit, si edhe shumë projekte të tjera.<br>LAGJJA E RE E TEKNOLOGJISË<br>Një lagje e re fantastike do t'i shtohet Korçës si një mundësi e shtuar për të rinjtë e angazhuar në fushën e teknologjisë me qëllim uljen e kostos së tyre të jetesës.<br>Një prej shtyllave më të forta të programit tonë në mandatin e ardhshëm është pikërisht trajnimi dhe punësimi i të rinjve në fushën e teknologjisë. | |  |
| 10/5/2023 | POLI I JUGUT Prezantimi i një prej projekteve më të rëndësishëm në mandatin tonë të ardhshëm, Poli i Jugut Drenovë-Boboshticë-Qatrom. Një projekt madhor që do të sjellë mundësi zhvillimi në bujqësi, turizëm, ekonomi dhe do ta kthejë Korçën në faktor të rëndësishëm për zhvillimin rajonal. | |  |
| 9/5/2023 | **AEROPORTI TURISTIK DHE SPORTIV**<br>Aeroporti Turistik dhe Sportiv i Korçës do të jetë një vlerë e jashtëzakonshme për turizmin në Korçë.<br>Ndërtimi i Aeroportit së shpejti do të jetë një realitet i prekshëm që do t'i japë një shtysë të madhe zhvillimit të turizmit rajonal dhe sporteve të aventurës. | |  |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 7/5/2023 | ?TERMOIZOLIMI I Image not found or type unknown<br>BANESAVE KOLEKTIVE në Korçë është një projekt tashmë i filluar nga bashkia.<br>Deri tani:<br>? 259 FAMILJE janë Image not found or type unknown<br>përfituese të këtij projekti<br>? 12 PALLATE kanë Image not found or type unknown<br>përfunduar në 4 lagje të qytetit të Korçës<br>? 15 PALLATE të tjera do të Image not found or type unknown<br>fillojnë së shpejti | |  |
| 3/5/2023 | TERMOIZOLIMI I PALLATEVE<br>Brenda 4 vitesh do të përfundojmë punën e nisur për termoizolimin e të gjitha banesave kolektive në Korçë. | |  |

Revision #1
Created 20 September 2023 12:46:27 by P. P
Updated 20 September 2023 12:49:50 by P. P